



MUNICIPAL PERFORMANCE GRANT
GRANTI I PERFORMANCËS KOMUNALE
OPŠTINSKI GRANT UČINKA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

30 Gusht 2022

Lënda: Informatë lidhur me aplikimin e kushteve minimale për grantin e performancës komunale 2023

I nderuar Kryetar,

Së pari, shfrytëzoj rastin të vlerësoj përpjekjet e juaja për të përmirësuar performancën e komunës suaj dhe për të raportuar saktë dhe me kohë të dhënat në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK). Kjo dëshmon se SMPK dhe Granti i Performancës Komunale (GPK) është duke patur ndikim në komuna dhe si rrjedhojë do të ndihmojë në përmirësimin e kualitetit të jetesës për qytetarët e Kosovës. GPK ua ka mundësuar komunave që të financojnë projekte të rëndësishme kapitale të cilat janë vitale për një rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm të komunës suaj. Ju përgëzoj për dedikimin e tuaj për jetësimin e këtyre projekteve.

Së dyti, ju informoj se procesi i vlerësimit të performancës për grantin e vitit 2023 është në fazën fillestare. Vlerësimi i performancës së vitit 2021 në SMPK është në perfundim dhe raporti i performancës do të publikohet gjatë javëve në vijim. Njëherësh, më lejoni t'ju falenderoj për bashkëpunim dhe ngritje të shqetësimeve lidhur me kushtet minimale të GPK-së. E vlerësojmë jashtëzakonisht komunikimin lidhur me këtë çështje, dhe për këtë dëshiroj të ofroj disa sqarime.

MAPL me përkrahje të projektit DEMOS dhe donatorëve të GPK-së, ka analizuar ndër të tjera të dhënat sidomos lidhur me shkallën e shpenzimit të buxhetit për investime kapitale duke pasur parasysh që: i) viti 2021 ka qenë vit zgjedhor dhe ii) Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk ka qenë funksional gjatë pjesës më të madhe të vitit. Po ashtu, kemi analizuar raportet e auditimit dhe e kemi konsultuar në mënyrë të veçantë me Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Nga të dhënat të cilat i kemi siguruar lidhur me shpenzimin e buxhetit si dhe të dhënat publike të ankesave tek OSHP, nuk ka evidencë që viti zgjedhor ose ankesat e pazgjithura në OSHP të kenë patur ndikim të rëndësishëm në përmbushjen e kushteve minimale në GPK.

Në vijim kemi analizuar edhe shkaqet e kualifikimit të opinionit të auditimit të komunave. Çështjet sikurse keqklasifikimi i shpenzimeve, regjistrimi jo i plotë ose i pasaktë i aseteve dhe çështjet lidhur me obligimet kontigjente janë çështje thelbësore të cilat duhet të adresohen jo vetëm që komunave t'iu garantohej besueshmëria e mjeteve nga donatorët dhe Qeveria, por edhe për të përmirësuar qeverisjen e

komunave. Këto çështje lidhen ngusht me synimet e GPK-së dhe kërkojnë vëmendje shtesë nga komunat në periudhën vijuese.

Duke marr parasysh çështjeve të theksuara si më lartë, por edhe në bazë të konsultimeve me donatorë, kemi vendosur që për grantin e vitit 2023 kushtet minimale të aplikohen siç kanë qenë për vitin 2022. Zbatimi i 4 kushteve shërben si garanci për komunitetin e donatorëve që komunat përfituese i kanë kapacitetet për të shfrytëzuar grantin në mënyrë efektive dhe në përputhje me ligjet në fuqi.

Gjithashtu, vijueshmëria kushteve minimale të pandryshuara na jep shpresë se do të shërbej si motiv për komunat të cilat kanë bërë përpjekje të jashtëzakonshme dhe përkundër sfidave, kanë arritur t'i përmbushin të gjitha kushtet minimale.

Ne jemi të përkushtuar që, së bashku me projektin DEMOS, të ofrojmë përkrahje shtesë komunave për të adresuar mangësitë e identifikuar në opinionin e auditmit.

Gjatë vitit 2023, do të bëhet një analizë e dizajnit të grantit, duke i përfshirë kushtet mininale. Kjo analizë do të bëhet në bashkëpunim me komunat, gjë e cila si pasojë mund të sjell ndryshime në vitet vijuese.


Mbesim në dispozicion që së bashku të adresojmë çdo çështje e cila ndikon në punën tuaj në shërbim të qytetarëve dhe të punojmë në adresimin e të gjitha mangësive, në mënyrë të tillë që sa më shumë komuna e qytetarë të përfitojnë në të ardhmen nga GPK.

Me respekt,
Elbert Krasniqi
Minister, MAPL

Kopje:
Venera Çerkini
Diellor Gashi
Donatoret
DEMOS



Co-funded by
the European Union



Sweden
Sverige



Norwegian Embassy

MUNICIPAL PERFORMANCE GRANT
GRANTI I PERFORMANCËS KOMUNALE
OPŠTINSKI GRANT UČINKA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr. 454-775
Br. No.
Data. 30.08.2022
Datum. Date.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

30.avgust 2022.

Predmet: Informacija u vezi sa aplikacijom minimalnih uslova za Grant opštinskog učinka za 2023.

Poštovani /a gradonačelnice/ca,

Prvo, koristim priliku da cenim vaše napore u cilju poboljšanja učinka vaše opštine i da tačno i blagovremeno dostavite podatke u Sistem upravljanja učinkom opštine (SUUO). Ovo dokazuje da SUUO i Grant za opštinski učinak (GOU) imaju uticaj na opštine i kao rezultat će pomoći da se poboljša kvalitet života građana Kosova. OGU je omogućio opštinama da finansiraju važne kapitalne projekte koji su od životnog značaja za dalji rast i razvoj vaše opštine. Čestitam vam na posvećenosti za relaizaciju ovih projekata.

Drugo, obavestavam vas da je proces procene učinka za grant za 2023. godinu, u početnoj fazi. Proces procene učinka za 2021. godinu, u SUUO-u je završen i izveštaj o učinku će biti objavljen u narednim nedeljama. U isto vreme, dozvolite mi da vam se zahvalim na saradnji i izražavanju zabrinutosti u vezi sa minimalnim uslovima OGU. Veoma cenimo komunikaciju u vezi sa ovim pitanjem i zato bih želeo da ponudim neka pojašnjenja.

MALS, uz podršku projekta DEMOS i donatora (Opštinskog granta za učinak) OGU-a, analizirao je podatke uglavnom u vezi sa troškovima budžeta za kapitalne investicije imajući u vidu da: (i) 2021. godina, bila je izborna godina i (ii) Telo za razmatranje nabavki nije bilo funkcionalno tokom dužeg dela godine. Takođe, smo analizirali i izveštaje o reviziji i konsultovali smo se na poseban način sa Nacionalnom kancelarijom za reviziju.

Iz podataka koje smo obezbedili u vezi sa troškovima budžeta kao i javnih podataka o žalbama prema Telu za razmatranje nabavki, ne postoji evidencija da je izborna godina ili nerešene žalbe u TRN-u imale značajan uticaj na ispunjavanje minimalnih uslova za OGU.

U zalaganju naših napora, analizirali smo i uzroke kvalifikacije mišljenja revizije opština. pitanja, poput loše kvalifikacije troškova registrovanja, nepotpuno ili netačno registrovanje imovina i pitanja koja se odnose na potencijalne obaveze su osnovna pitanja koja treba da se upućuju ne samo da bi se opštinama moglo poverovati sredstva donatora i vlade, ali i za dobro upravljanje od strane opština. Ova pitanja su usko povezana sa ciljevima OGU-a i zahtevaju dodatnu pažnju vaše opštine kako bi prevazišli u narednom periodu.

Uzimajući u obzir sve ovo i konsultacije sa donatorima, odlučili smo da se za grant za 2023. godinu, primenjuju minimalni uslovi onakvi kakvi su bili i kao što su obavešteni sve opštine, bez ikakvih promena. Sprovedenje četiri (4) minimalna uslova takođe garantuje zajednici donatora da opštine korisnici imaju kapacitet da koriste grant u skladu sa zakonodavstvom na snazi i efikasno.

S druge strane, održavanje neizmenjenjih minimalnih uslova, nadamo se da će motivisati još više opštine koje su činile izuzatan napor uprkos izazova i uspele su da ispunjavaju sve minimalne uslove.

Posvećeni da zajedno sa projektom DEMOS, pružamo dodatnu podršku za opštine na osnovu posebnih potreba radi upućivanja identifikovanih nedostataka u revizijskom mišljenju.

Tokom 2023. godine, biće izvršena analiza dizajna granta, uključujući minimalne uslove. Ovakva analiza će biti urađena u saradnji sa opštinama i može rezultirati eventualnim promenama u narednim godinama.

Ostajemo na raspolaganju da zajedno rešimo svako pitanje koje utiče na vaš rad u službi građana i da radimo na otklanjanju svih nedostataka, kako bi što više opština i građana u budućnosti koristilo OGU.

S poštovanjem,
Elbert Krasniqi
ministar MALS-a

Kopija:
Venera Cerkini
Diellor Gashi
Donatoret
DEMOS



Co-funded by
the European Union



Sweden
Sverige



Norwegian Embassy

MUNICIPAL PERFORMANCE GRANT
GRANTU I PERFORMANCËS KOMUNALE
OPŠTINSKI GRANT UČINKA

REPUBLIKA KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVAT / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. No. 454-775
Data. Datum. Date. 30.08.2022

-11-



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

30 August 2022

Subject: Information related to application of Minimum Conditions for the Municipal Performance Grant 2023

Dear Mayor,

Firstly, I would like to take the opportunity to praise your efforts to improve the performance of your municipality and to report accurate and timely data for the Performance Management System (PMS). This demonstrates that the PMS and the Municipal Performance Grant (MPG) is having an impact in municipalities and consequently will help improve the quality of life of people across Kosovo municipalities. The MPG has enabled municipalities to fund a variety of important capital investment projects, which are vital for the continued growth and development of your community. I commend you for your dedication to making them a reality.

Secondly, I would like to inform you that the performance assessment process for 2023 grants is commencing. The performance assessment as part of PMS is near the end and the PMS report will be published in the weeks to come. Thank you for raising your concerns about the minimum conditions of the MPG. We appreciate your feedback about this issue, and would like to provide some clarifications.

MLGA with DEMOS support has analysed the data, especially related to capital budget expenditure rate taking into account that: i) 2021 was an election year and ii) Procurement Review Body was not functional during most of 2021. In addition, we looked at the audit reports and consulted with the National Audit Office.

From data that we have obtained related to capital investment expenditure rate, and public data from the Procurement Review body related to complaints, there is no evidence that the election year or unresolved complaints pending at the PRB had a significant impact of fulfilment of minimum conditions of the MPG.

Further, we have also analyzed the reasons for the qualification of the audit opinion of municipalities. Issues such as the misclassification of expenditures, incomplete and inaccurate asset registry as well as issues related to contingency liabilities are fundamental issues that need to be addressed not only for municipalities to be entrusted to receive grants from donors and the Government but also for the good governance of municipalities. These issues are closely related to the objectives of the MPG and require additional attention from your institution to be overcome in the following period.

Taking into account all of the above and consultations that we had with the donors, we have decided that at least for the grant of 2023 minimum conditions will be applied as they are, without any change. Application of all 4 minimum conditions guarantees the donor community that benefitting municipalities have the capacity to use the grant in compliance with the applicable laws and in an effective manner.

On the other side, we hope that by keeping the minimum conditions unchanged we will motivate even further municipalities that made extraordinary efforts and despite challenges, have been able to meet all minimum conditions.

We are committed together with the DEMOS project to offer additional support to municipalities based on specific needs to address weaknesses identified in the audit opinion.

During the year 2023, an analysis of the grant design will take place, including minimum conditions. The analysis will be done in close cooperation with municipalities and may result in eventual changes in the upcoming years.

We remain at your disposal to address together any issue which affects your work in service to the citizens and to work together in addressing all weaknesses so that as many municipalities and citizens benefit from the MPG in the future.

Yours faithfully,

Elbert Krasniqi
MLGA Minister

Cc:
Venera Çerkini
Diellor Gashi
All donors
DEMOS



Co-funded by
the European Union



Sweden
Sverige



Norwegian Embassy



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Rregullat e

GRANTIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE

për vitin fiskal 2023

bazuar ne vlerësimin e performancës për vitin fiskal 2021

Gusht, 2022

Me mbështetje teknike dhe financiare nga:






Tabela e përmbajtjes

Parathënie	4
1. Granti i performancës komunale - Hyrje	6
1.1 Hyrje	6
1.2 Baza juridike	6
1.3 Qëllimi.....	7
1.4 Temat kyçe.....	7
1.5 Mbulueshmëria gjeografike.....	7
1.6 Orientimi strategjik.....	7
1.7 Struktura dhe audienca e synuar.....	8
2. Granti i performancës komunale– Parametrat dizajnues	9
2.1 Parimet themelore	9
2.2 Kushtet minimale.....	9
2.3 Treguesit e performancës komunale.....	10
2.4 Burimet e financimit të grantit të performancës komunale	12
2.5 Llogaritja e shumës së grantit të performancës komunale	12
2.6 Kriteret për shfrytëzimin e grantit të performancës komunale	13
2.7 Auditimi i grantit të performancës komunale	13
3. Granti i performancës komunale – Procesi i vlerësimit.....	14
3.1 Aranzhimet institucionale.....	14
3.2 Afati kohor	15
3.3 Procedurat e vlerësimit	16
4. Shtojcat.....	19

Parathënie

Në vitin 2009, Kosova ishte vendi i parë në rajon që aprovoi skemën stimuluese financiare të bazuar në performancë, përmes ndarjes së fondeve për komunat si nxitje për përmirësimin e qeverisjes lokale. Në fund të vitit 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në partneritet me Zyrën Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zhvilluan dhe u pajtuan të bashkëfinancojnë një skemë unike për ndarjen e grantit të performancës për komunat. Në vitin 2019, Suedia dhe Norvegjia kanë vendosur që të bashkëfinancojnë skemën e GPK. Në vitin 2022, BE përmes Suedisë poashtu i bashkohet financimit të skemës së GPK.

Ndërmjet viteve 2018 dhe 2021, rreth 14 milionë euro janë alokuar në komunat përfituese, si grante të performancës komunale. Ndërmjet viteve 2022-2025, shuma e grantit të performancës komunale pritet të jetë rreth 30 milionë euro. Ky grant synon përmirësimin e performancës së komunave në fushat: 'qeverisja demokratike', 'menaxhimi komunal' dhe 'ofrimi i shërbimeve'.

Granti i performancës komunale për vitin 2023 do t'iu ndahen komunave në pajtim me kriteret e llogaritjes së grantit dhe pikët e arritura në performancën komunale në bazë të një numri treguesish të shtrirë në tri fusha kryesore të përmendura si më lartë.

Shuma e grantit në vitin 2023 pritet të jetë rreth 7.8 milionë euro. Të gjitha komunat e Kosovës gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në grantin e performancës komunale, sipas kushteve të përcaktuara në këto rregulla. Granti për vitet 2022-2025 pritet të bashkëfinancohet nga Qeveria e Kosovës përfaqësuar nga MAPL dhe kontributdhënësit si BE, Suedia, Zvicra dhe Norvegjia.

Granti i performancës komunale (GPK) ka për qëllim të nxisë konkurrencën ndërmjet komunave, duke ndjekur parimin që performanca më e mirë të shoqërohet me vlerë më të madhe të grantit. Së këndejmi, GPK synon të përkrahë komunat në dy mënyra: së pari, duke e inkurajuar pajtueshmërinë komunale me standardet minimale ligjore (standardet themelore); së dyti, duke stimuluar performancën 'reale' që shkon përtej kërkesave ligjore ('të detyrueshme').

GPK bazohet në parimet e mëposhtme:

- Komunat duhet të plotësojnë një numër kushtesh minimale që të mund të kualifikohen për grant në baza vjetore;
- Për të gjitha komunat që kanë plotësuar kushtet minimale, shuma e grantit që merr secila komunë bazohet në performancën e arritur në treguesit e performancës në krahasim me performancën e të gjitha komunave të tjera, si dhe elemente të tjera të kriterëve të vlerësimit siç përcaktohet në këto rregulla.

Pasi që komunat të kualifikohen, lartësia e grantit do të përcaktohet nga pikët (rezultati) relative të fituara në treguesit e performancës. Treguesit janë pasqyrim i objektivave të politikave të qeverisë, që synojnë realizimin e vizionit të përgjithshëm të komunave si '*institucione demokratike vibrante të qeverisjes lokale që ofrojnë shërbime cilësore dhe u përgjigjen nevojave dhe prioritetëve të qytetarëve*'.

Ky dokument përcakton kontekstin, objektivat, rregullat, kriteret dhe procedurat për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës komunale.

Po ashtu, ky dokument informon të gjithë akterët lidhur me rregullat dhe procedurat e grantit të performancës.

Dokumentit përcakton përgjegjësitë e akterëve në nivelin qendror, përfshirë: (i) grupit teknik përgjegjës për vlerësimin e grantit të performancës; (ii) komisionit të grantit të performancës, përgjegjës për ndarjen e grantit të performancës komunale; (iii) komisionit të ankesave përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të

komunave; dhe (iv) grupit përgjegjës për përgatitjen e rregullave të grantit të performancës komunale dhe adresimin e tyre për aprovim në Komisionin e GPK-së.

MAPL dhe kontributdhënësit inkurajojnë të gjithë akterët lokal përkatës të konsiderojnë grantin e performancës komunale si një mundësi të mirë për të kuptuar më mirë performancën komunale (duke përfshirë fushat e përmirësuar dhe ato ku ka nevojë për përmirësim) dhe për të qenë pjesë e konkurrencës së shëndoshë me komunat e tjera në përpjekje të përmirësimit të kapaciteteve komunale dhe ofrimit efikas dhe efektiv të shërbimeve publike për qytetarë.

Rezultatet e vlerësimit të performancës komunale do të shpallen publikisht nga MAPL dhe do t'iu komunikohen të gjitha komunave.

1. Granti i performancës komunale - Hyrje

1.1 Hyrje

Komunat në Kosovë, si subjekte të qeverisjes së decentralizuar lokale, luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin e sektorit publik. Përveç përgjegjësisë për ofrimin e një varg shërbimesh, komunat në njërin anë shërbejnë si pikë e parë kontaktuese ndërmjet qytetarëve dhe shtetit, dhe në anën tjetër, ato u japin mundësinë qytetarëve të marrin pjesë në vendimmarrje.

Administrata lokale konsiderohet një nga shtyllat kryesore të shtetit dhe promotor i zhvillimit social dhe ekonomik. Krahasuar me shumë vende të tjera, komunat në Kosovë qëndrojnë relativisht mirë në ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, ende ka nevojë për përmirësime në ushtrimin e kompetencave vetanake komunale, kur kemi parasysh shkallën e lartë të papunësisë në vend dhe shkallën e ulët të zhvillimit ekonomik. Si rrjedhojë është e pranishme nevoja për përmirësimin e kontrollit dhe menaxhimit financiar, si dhe investime më të mëdha përmes projekteve strategjike. Institucionet lokale duhet t'i inkurajojnë nëpunësit publik për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të tyre, për të krijuar një administratë moderne lokale të aftë për ofrimin e shërbimeve efikase për të gjithë qytetarët pa dallim.

Të gjeturat nga raportet vendore dhe të institucioneve kredibile ndërkombëtare akoma nënvizojnë probleme me reformën e administratës publike. Kjo e fundit mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të vendit, për çfarë kërkohet vëmendje e veçantë. Organet e pushtetit lokal duhet të shtojnë intensitetin e punës së tyre dhe të ofrojnë një qasje të re qeverisëse e cila do të rriste besueshmërinë e qytetarëve ndaj institucioneve të tyre lokale. Sigurisht që suksesi apo mospuksesi do të varet nga angazhimi i përbashkët në ndërtimin e një administrate funksionale dhe përkushtimi i institucioneve komunale për të reaguar ndaj këtyre problemeve.

Marrë parasysh këtë, Granti i Performancës Komunale përcakton një numër objektivash për pushtetin lokal në mënyrë që të rriten kapacitetet institucionale në ushtrimin e kompetencave dhe trajtimin efektiv të çështjeve që ndikojnë në jetën e qytetarëve.

Lidhur me këtë, temat në vijim janë identifikuar si objektiva prioritare për përmirësimin e performancës komunale, si vijon:

- **Komunat të funksionojnë si institucione lokale demokratike** - që respektojnë standardet ligjore të transparencës, me kuvend komunal të fuqishëm që i përfaqëson qytetarët dhe ka pushtetin të mbikëqyrë ekzekutivin, ndërsa qytetarët kanë mundësinë të shfaqin shqetësimet dhe sugjerimet e tyre;
- **Komunat të kenë një menaxhim efektiv dhe efikas komunal** - që është neutral dhe i paanshëm; dhe
- **Komunat të ofrojnë shërbime cilësore** - në përgjigje ndaj prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve, duke i trajtuar të gjithë në mënyrë të barabartë.

1.2 Baza juridike

Rregullat e Grantit të Performancës Komunale (GPK) janë të normuara me Rregulloren 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale.

Aspektet e tjera materiale dhe procedurale janë objekt i trajtimit në Rregullat e GPK-së të përcaktuara në këtë dokument.

1.3 Qëllimi

GPK ofrohet në formë të përkrahjes financiare për komunat dhe ka për qëllim stimulimin e tyre që të përmirësojnë performancën në fusha të caktuara, respektivisht në qeverisje lokale demokratike, menaxhim të mirë komunal dhe ofrim të shërbimeve.

1.4 Temat kyçe

Duke pasur parasysh analizën e faktorëve kritikë, të cilët mund t'i pengojnë komunat të bëhen 'institucione demokratike vibrante të qeverisjes lokale që ofrojnë shërbime cilësore', GPK do të fokusohet në tre temat e mëposhtme:

- Qeverisja demokratike;
- Menaxhimi komunal;
- Ofrimi i shërbimeve.

Këto tre tema ndahen tutje në dhjetë nëntema siç paraqitet më poshtë në Tabelën 1. Në kuadër të këtyre nëntemave, janë identifikuar 30 tregues të performancës, prej të cilëve 27 tregues performance do të maten për performancën e vitit 2021. Kjo do t'iu mundësojë komunave të marrin 92 pikë (prej 100 pikëve) në vlerësimin e performancës të vitit 2021. Nënkapitulli 2.3 ofron më tepër sqarime për këtë. Pikët e fituara përcaktojnë shumën e grantit që merr komuna duke u bazuar në performancën e saj.

Tabela 1: Tre temat kryesore dhe dhjetë nën-temat me pikët maksimale

Temat dhe nën-temat	Pikët maksimale të mundshme
1. Qeverisja demokratike	38
I Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	11
II Pjesëmarrja, konsultimi i qytetarëve dhe gjithëpërfshirja	12
III Transparenca, çasja në informata dhe integriteti	15
2. Menaxhimi komunal	28
IV Menaxhimi financiar	13
V Menaxhimi i kontratave	7
VI Menaxhimi i burimeve njerëzore	8
3. Ofrimi i shërbimeve	26
VII Shërbimet administrative	6
VIII Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	8
IX Arsimiti para-universitar	4
X Kujdesi primar shëndetësor	8
Numri maksimal i pikëve	92

1.5 Mbulueshmëria gjeografike

GPK është instrument financiar i krijuar për të gjitha komunat e Kosovës. Qasje në GPK kanë të gjitha komunat që plotësojnë kushtet minimale të përcaktuara në këtë dokument.

1.6 Orientimi strategjik

GPK është grant shtesë për komunat i paraparë në Ligjin vjetor të buxhetit të Kosovës - tabela e alokimit të buxhetit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Qëllimi strategjik është integrimi i grantit të performancës komunale në ligjin për financat e pushtetit lokal të Kosovës ose Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe rregullimi me ligjin e veçantë për performancën komunale.

GPK ofrohet si përkrahje shtesë për projektet kapitale të komunave, lartësia e të cilit përcaktohet në bazë të formulës për alokimin e grantit me variabla, si: madhësia e popullsisë, madhësia gjeografike, përbërja etnike që llogariten mbi shumën fikse bazë¹, si dhe pikët e performancës.

Për shpenzimin e Grantit të Performancës Komunale, zbatohen të gjitha rregullat ekzistuese të Qeverisë (të cilat zbatohen për investimet kapitale në kuadër të grantit të përgjithshëm) në aspektin e përdorimit të grantit, planifikimit të grantit, si dhe të raportimit dhe llogaridhënies. Kjo nënkupton që komunat mund të përdorin procedurat e tyre ligjore të tenderimit, kontraktimit dhe pranimin teknik. Granti mund të përfshihet në auditimin e rregullt të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Pra, GPK administrohet si grant qeveritar për komunat. Veçoritë/karakteristikat e vetme që shtohen këtu janë kushtet minimale dhe treguesit e performancës.

Meqenëse plani është që GPK të bëhet pjesë e kornizës ligjore për financat lokale në vitet e ardhshme si dhe ligjit të veçantë për performancë komunale dhe grant të performancës, i njëjti duhet të harmonizohet sa më shumë që është e mundur me sistemet qeveritare dhe procedurat administrative aktuale të Kosovës. Ministritë e linjës dhe kontributdhënësit që dëshirojnë t'iu delegojnë përgjegjësitë dhe fondet e ndërlidhura qeverive lokale do të inkurajohen t'i harmonizojnë grantet e tyre me dispozitat për GPK-së, të cilat bazohen në matjen e qeverisjes së mirë. Kjo do të krijonte avantazh edhe për grantin e tyre (sektorial) dhe GPK. Për shembull, mund të përdoren të njëjtat kushte minimale, ndoshta në kombinim me një përqindje minimale të pikëve (rezultatit) të performancës. Kontributdhënësit që dëshirojnë të investojnë në çështjet që kanë të bëjnë me qeverisje të mirë do të inkurajohen t'i kanalizojnë fondet e tyre drejtpërdrejt në fondin e përbashkët për GPK.

1.7 Struktura e rregullave dhe audienca e synuar

Ky dokument shpjegon kriteret, rregullat dhe procedurat për menaxhimin e Grantit të Performancës Komunale:

Kapitulli 1 – ofron një përmbledhje të shkurtër të justifikimit të GPK dhe fushave ku përqendrohet;

Kapitulli 2 - përkufizon kushtet minimale, treguesit e performancës, si dhe parimet për ndarjen e grantit dhe auditimin e GPK;

Kapitulli 3 - prezanton procesin e vlerësimit të performancës komunale nga mbledhja e të dhënave e deri te ndarja e grantit.

Shtojcat japin udhëzime më të hollësishme të vlerësimit (dhënies së pikëve) për kushtet minimale (shtojca 1) dhe për treguesit e performancës (shtojca 2), ku jepen përkufizimet e asaj që matet, nga vijnë të dhënat dhe si maten. Shtojca 3 - jep shabllonin për fletëvlerësimin dhe tregon si caktohen pikët e performancës që do të përdoret për komunikimin e pikëve (rezultatit) të performancës për komunat. Shtojca 4 - përshkruan hollësisht se si përllogariten shumat e grantit për secilën komunë pasi të dihen pikët e performancës. Shtojcat 5, 6, 7 dhe 8 përshkruajnë Termet e Referencës të komisionit të GPK-së, grupit teknik për vlerësim të grantit, komisionit të ankesave dhe komisionit për hartimin e rregullave të GPK-së. Shtojca 9 jep të dhënat kontaktuese.

Ky dokument synon të informoj të gjithë akterët e komunave të Kosovës, përfshirë kryetarët e komunave, drejtorët, udhëheqësit e lartë, koordinatorët e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), anëtarët e kuvendeve të komunave, si dhe shoqërinë civile dhe qytetarët e interesuar.

Rregullat e GPK-së janë me interes për të gjitha ministritë që hartojnë politika për komunat, si dhe organizatat joqeveritare (OJQ) që trajtojnë ofrimin e shërbimeve lokale dhe qeverisjen lokale. Ky dokument po ashtu mund të shërbejë si përmbledhje për partnerët zhvillimorë të cilët mendojnë t'i bashkëngjiten grantit të performancës komunale.

¹ Formula e alokimit për grantin e përgjithshëm është përkufizuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (Ligji nr. 03/ L- 049)

2. Granti i performancës komunale – Parametrat dizajnuar

2.1 Parimet themelore

GPK bazohet në parimet e mëposhtme:

- Komunitat duhet që për secilin vit të plotësojnë një numër kushtesh minimale që të mund të kualifikohen për marrjen e grantit në baza vjetore (në pajtim me nenin 30.2 të Rregullores për SMPK dhe për skemën e grantit për performancë komunale);
- Për të gjitha komunitat që kanë plotësuar kushtet minimale, granti shtesë që merr secila komunë bazohet në pikët e saj relative të arritura në treguesit e performancës komunale (pikët e saj në krahasim me ato të të gjitha komunave të tjera) si dhe kritereve të tjera të formulës së alokimit, në pajtim me nenin 30.3 të Rregullores për SMPK dhe për skemën e grantit për performancë komunale.

Kushtet minimale kanë për qëllim të sigurojnë që shuma në dispozicion t'iu ndahet vetëm komunave që janë në gjendje t'i shfrytëzojnë me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet mjetet financiare; janë në gjendje të absorbojnë fonde dhe t'i shpenzojnë në mënyrë të përgjegjshme; kanë rishikuar aktet komunale të vlerësuara të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës dhe kanë raportuar me kohë në SMPK.

Treguesit e performancës komunale (dhe pikët relative) kanë për qëllim të nxisin konkurrencën ndërmjet komunave për të siguruar burime financiare shtesë, por edhe synimin e të qenit ndër komunitat me pikët më të larta në fushat kyçe të performancës. Publikimi i rezultateve të vlerësimit (dhe diskutimi publik lidhur me analizën e rezultateve të vlerësimit) është një aspekt i rëndësishëm i GPK-së.

2.2 Kushtet minimale

GPK për vitin 2023 përcakton katër kushte minimale si vijon:

1. Komunitat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar në nenin 13 të Rregullores së SMPK/GPK²;
2. Komunitat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për të rishikuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës³;
3. Opinioni i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes; dhe
4. Komunitat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale.

Prandaj, komunitat të cilat nuk arrijnë të përmbushin cilindo nga katër kushtet e mësipërme, nuk mund të përfitojnë nga granti i performancës komunale.

Arsyetimi i kushteve minimale është që:

- Komunitat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK për performancën e vitit 2021, sipas afatit të paraparë.
- Granti do t'iu jepet atyre komunave që e kanë respektuar obligimin ligjor për t'i rishikuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme në vitin 2021, nga autoriteti mbikëqyrës⁴.
- Për të marrë grantin, komunitat duhet të kenë sistem për menaxhim financiar mjaftueshëm të shëndoshë, siç dëshmohet nga raportet individuale të auditimit të rregullsisë për vitin 2021, të publikuara nga ZKA; dhe
- Granti do t'iu jepet vetëm atyre komunave që kanë dëshmuar se kanë kapacitete të mjaftueshme për të absorbuar fondet shtesë, siç tregohet nga shkalla e shpenzimit të buxhetit

² Afati i raportimit të të dhënave të performancës nga komuna është 45 ditë kalendarike nga momenti i pranimit të kërkesës për raportim nga ministria

³ Rishikimi për qëllime të GPK-së është kriter procedural, që nënkupton obligimin e komunës për të rishikuar në Kuvendin e Komunës aktet e vlerësuara si të kundërligjshme në vitin 2021 nga autoriteti mbikëqyrës, pa presupozuar përmbajtjen përfundimtare të aktit të rishikuar.

⁴ Autoriteti mbikëqyrës nënkupton MAPL-në dhe ministrinë e linjës

final për investime kapitale në raportet individuale të auditimit të rregullsisë për vitin 2021, të publikuara nga ZKA.

Të katër kushtet minimale duhet të plotësohen para se komuna të kualifikohet për grantin e performancës komunale. Shtojca 3 jep shabllonin për t'i komunikuar secilës komunë rezultatet e vlerësimit të kushteve minimale.

Burimet e të dhënave për katër kushtet minimale janë përcaktuar në shtojcën 1 të këtyre rregullave.

2.3 Treguesit e performancës komunale

Burimi kryesor i të dhënave për treguesit e GPK është Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) i MAPL-së.

Sic shihet në tabelën 2 më poshtë, janë identifikuar gjithsej 30 tregues të performancës komunale (3 të ngrirë në këtë vlerësim) brenda tre temave kryesore dhe dhjetë nëntemave (shih tabelën 1 më lart). Është e rëndësishme të përmendet se 27 tregues do të vlerësohen për përcaktimin e grantit që jepet në Vitin Fiskal 2023, për të cilët vlerësimi bëhet bazuar në performancën e vitit 2021. Numri maksimal i pikëve për 27 treguesit që do të vlerësohen është 92 pikë.

Tabela 2: Përmbledhje e temave të grantit të performancës komunale për vlerësim të performancës 2021⁵

#	Tema / Fusha e treguesit	# maks. i pikëve
I. QEVERISJA DEMOKRATIKE		38
I	Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	11
1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	2
2	Diskutimi për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	3
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin paraprak ⁶	2
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal	4
5	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	2
II	Pjesëmarrja, konsultimi i qytetarëve dhe gjithëpërfshirja	12
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike, e disagreguar sipas gjinisë	4
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	4
8	Dëgjime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe buxhet komunal	4
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	15
9	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejtë online	3
10	Përbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës	4
11	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	2
12	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	4
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para Kuvendit Komunal	2
II. MENAXHIMI KOMUNAL		28
IV	Menaxhimi financiar	13
14	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	3
15	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	5
16	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	5

⁵ Shpjegimi më i hollësishëm i temave, treguesve dhe ngjyrave mund të gjendet në tekst dhe në shtojcën 2.

⁶ Ky tregues është i ngrirë për shkak që raporti i SMPK për vitin 2020 është publikuar nga MAPL pas afatit për diskutim të raportit të performancës komunale nga Kuvendi Komunal

V	Menaxhimi i kontratave	7
17	Niveli i zbatimit i planit të prokurimit	3
18	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	4
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	8
19	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNJ ⁷	2
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	5
21	Gra të emëruara në postet politike në komunë	3
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE		26
VII	Shërbimet administrative	6
22	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	4
23	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	2
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	8
24	Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme) ose harta zonale	3
25	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	3
26	Realizimi i planit lokal të veprimit në mjedis	2
IX	Arsimi para-universitar	4
27	Fëmijët që vijojnë kopshtin - rural dhe përgjithësi ⁸	4
28	Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12	4
X	Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH)	8
29	m ² të hapësirave të Kujdesit Primar Shëndetësor për 10000 banorë	3
30	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjarë edhe 2 infermierë për 2000 banorë	5
Totali i pikëve		92

Treguesit pasqyrojnë fushat e performancës komunale që: (i) konsiderohen të rëndësishme për një funksionim të mirë të strukturave komunale si subjekte të qeverisjes lokale demokratike dhe (ii) konsiderohen të kenë hapësirë për përmirësim, në të gjitha nivelet për të gjitha komunat. GPK përqëndrohet në fushat ku komunat kanë nevojë dhe mund të bëjnë përmirësime të mëtejshme. Granti do të krijojë stimuj për të lehtësuar këtë ndryshim.

Treguesit e ndryshëm kanë pikë të ndryshme maksimale, në lidhje me peshën dhe rëndësinë e atribuar të tyre. Shtojca 3 ka një udhëzues të detajuar mbi caktimin e pikëve brenda pikëve maksimale. Pikët janë kalibruar në mënyrë të tillë që të shpërblehen nivele të mira dhe të pranueshme të performancës, por që për secilin tregues, për performancën nën-optimale jepen shumë pak ose aspak pikë, që do të thotë se pikët me të vërtetë stimulojnë performancën e mirë (në vend të performancës mesatare). Kjo gjithashtu do të thotë se komunat që performojnë mirë në një numër treguesish do të marrin ndjeshëm më shumë pikë se ato që tregojnë performancë të zakonshme.

Është e rëndësishme të theksohet se treguesit janë përzgjedhur dhe formuluar në mënyrë të tillë që të jenë të arritshëm në të njëjtën mënyrë nga të gjitha komunat, pavarësisht nga popullsia, madhësia e territorit apo fuqia ekonomike. Në parim, treguesit pasqyrojnë atributet që të gjitha komunat *'duhet t'i kenë'* - pasi ato janë pjesë e qeverisjes së mirë lokale, gjë që ju takon të gjithë qytetarëve të Kosovës.

⁷ Ky tregues është i ngrirë për shkak të ndryshimit të ligjit për zyrtarët publik dhe mungesës së legjislacionit sekondar lidhur me procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

⁸ Ky tregues është i ngrirë në këtë cikël të vlerësimit për shkak të mungesës së të dhënave në SMPK.

Treguesi nr. 3 (me ngjyrë portokalli në Tabelën 2) është i ngrirë që do të thotë se rezultati për këtë tregues nuk do të merret parasysh në totalin e pikëve, për shkak të publikimit me vonesë të Raportit të Performancës Komunale për vitin 2020, nga MAPL.

Treguesi nr.19 (me ngjyrë portokalli në Tabelën 2) është i ngrirë që do të thotë se rezultati për këtë tregues nuk do të merret parasysh në totalin e pikëve, për shkak të ndryshimit të ligjit për zyrtarët publik dhe mungesës së legjislacionit sekondar lidhur me procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

Treguesi nr. 27 (me ngjyrë portokalli në Tabelën 2) është 'ngrirë' që do të thotë se rezultati për këtë tregues nuk do të merret parasysh në totalin e pikëve, për arsye se nuk ka të dhëna të sakta për këtë tregues dhe nuk janë raportuar në SMPK për vitin 2021.

2.4 Burimet e financimit të grantit të performancës komunale

GPK për vitin 2023 pritet të bashkëfinancohet nga Qeveria e Kosovës (nga alokimi buxhetor i MAPL-së), Suedia dhe Bashkimi Europian, Zvicra, dhe Norvegjia.

Plani i financimit të GPK për vitin 2023 është siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë. Të gjitha shumatat e planifikuara për GPK janë indikative dhe janë subjekt i aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kontributdhënësve.

Për të monitoruar ndikimin e projekteve tek qytetarët, do të implementohet auditimi shoqëror në kuadër të GPK. Shuma për auditimin shoqëror për vitin 2023 është zbritur nga totali i shumës së GPK. Andaj në tabelën 3 është paraqitur shuma indicative e GPK që do të alokohet komunave.

Tabela 3: Burimet e financimit të grantit të performancës komunale 2023 (në Euro)

Fondet	Burimi	Total 2023
Shuma indikative e GPK në dispozicion për komuna	Qeveria e Kosovës /MAPL	3,500,000
	Kontributdhënësit (BE, Suedia, Zvicra dhe Norvegjia)	4,271,500
Buxheti për auditim shoqëror	Kontributdhënësit (BE, Suedia, Zvicra dhe Norvegjia)	78,500
	Gjithsej	7,850,000

2.5 Llogaritja e shumës së grantit të performancës komunale

Treguesit janë definuar në mënyrë të tillë që të gjitha komunat, pavarësisht nga madhësia, vendndodhja apo fuqia ekonomike, mund të jenë një performues i mirë, me kusht që të bëjnë përpjekje për të performuar si një qeveri lokale demokratike që i shërben popullatës së saj.

90% e shumës së përgjithshme të GPK ndahet bazuar në formulë, ndërsa 10% e shumës së përgjithshme ndahet për shpërblime shtesë për komunat në 3 vendet e para me performancën më të mirë.

Vendi i parë i merr 5% të shumës totale të grantit; vendi i dytë i merr 3% të shumës totale të grantit dhe vendi i tretë i merr 2% të shumës totale të grantit.

Nëse dy e më shumë komuna kanë të njëjtin rezultat të performancës, atëherë shuma e shpërblimit për vendin e përcaktuar ndahet në mënyrë proporcionale për atë numër të komunave me rezultat të njëjtë.

Shuma e GPK bazuar në formulë (90% e shumës së përgjithshme të GPK) përcaktohet nga:

- Performanca relative e secilës komunë e matur sipas treguesve të përcaktuar të performancës; dhe
- Pësia e grantit të performancës komunale në grantin e përgjithshëm të alokuar.

Në fakt, GPK do të ndahet në bazë të pikëve relative, në mënyrë të tillë që dy komuna të cilat kanë një rezultat të njëjtë do të marrin një shtesë relative të barabartë në pjesën e investimeve kapitale të grantit të përgjithshëm. Kjo do të thotë që të dy komunave do t'iu ndahet një grant që është e njëjta përqindje e

grantit të tyre të përgjithshëm (ndërsa shumat absolute të grantit të performancës komunale do të ndryshojnë). Madhësia e shumës absolute është proporcionale me grantin e përgjithshëm. Arsyetimi për këtë është i qartë: një komunë që ka një grant të përgjithshëm më të madh ka nevojë për një shumë më të madhe për të pasur të njëjtin stimulim sa i përket përmirësimit të performancës së saj. Shtojca 4 tregon se si llogaritet ndarja e GPK.

2.6 Kriteret për shfrytëzimin e grantit të performancës komunale

Granti përdoret për të financuar projekte komunale në dobi të qytetarëve, konform rregullave dhe parimeve në vijim:

- GPK përdoret vetëm për investime kapitale dhe nuk mund të përdoret për paga, mallra, shërbime apo subvencione;
- Komuna është e lirë të vendosë për cilat investime do të përdoret granti i performancës komunale. Rekomandohet që komunat të fokusohen në projekte konkrete, të kufizuara në numër, për të shmangur procedurat e gjata administrative dhe për t'i shfrytëzuar mjetet brenda vitit fiskal⁹;
- Granti duhet të shfrytëzohet nga komuna konform legjislacionit në fuqi. Në rast se komuna nuk e shpenzon grantin konform këtyre rregullave dhe legjislacionit në fuqi, obligimet kontraktuale ndaj operatorëve ekonomik barten nga vetë komuna;
- Shfrytëzimi i grantit i nënshtrohet rregullave të mbikëqyrjes dhe kontrollit konform legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe rregullave të grantit të performancës komunale.

2.7 Auditimi i grantit të performancës komunale

Shpenzimet e GPK-së mund të auditohen si pjesë e auditimit të rregullt nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

- MAPL dhe kontributdhënësit mund të dakordohen që të bëhet një *auditim vjetor i posaçëm*, për të shqyrtuar aspekte të caktuara në lidhje me GPK. Auditimi mund të përfshijë funksionimin e GPK-së, proceset e prokurimit, procedurat e pranimi teknik të shërbimeve, pagesat, etj. Detajet për këtë auditim specifikohen në bashkëpunim me kontributdhënësit.
- Në rast të konstatimit të shkeljeve dhe parregullsive të evidentuara nga auditimi, si keqdeklarime materiale, MAPL dhe kontributdhënësit mund të vendosin për përjashtimin e komunës nga e drejta e përfitimit të grantit për një periudhë të caktuar, në pajtim me nenin 42.2 të Rregullores 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Granteve për Performancë Komunale.
- Për të monitoruar ndikimin e projekteve tek qytetarët, do të zbatohet shoqëror, si pjesë e GPK-së. Auditimi shoqëror do të përfshijë monitorimin e performancës dhe proceset e planifikimit të projekteve në nivel komunal. Auditimi shoqëror do të paguhet nga një pjesë e fondeve të GPK (pjesa e donatorëve) dhe do të kryhet nga organizata të shoqërisë civile. Rezultatet e auditimit shoqëror i raportohen Komisionit të GPK-së.

⁹ Pjesa e fondeve të GPK e financuar nga donatorët shfrytëzohet gjatë vitit 2023 dhe 2024.

3. Granti i performancës komunale – Procesi i vlerësimit

3.1 Aranzhimet institucionale

Komisioni i grantit të performancës komunale dhe grupi teknik janë organet përgjegjëse për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës komunale.

Komisioni i ankesave shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesat e komunave.

Përgatitja e Rregullave të Grantit të Performancës para çdo cikli vlerësues bëhet nga Grupi Punues përgjegjës për hartimin e Rregullave të GPK-së i themeluar nga Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së në bashkëpunim me kontributdhënësit.

3.1.1 Komisioni i grantit të performancës komunale

Komisioni i grantit të performancës komunale është organi më i lartë vendimmarrës për GPK.

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të grantit të performancës komunale janë:

- Vendosja e rregullave dhe procedurave të punës së komisionit;
- Mbikëqyrja e procesit dhe siguroim që Grupi Teknik ka ndjekur kriteret dhe procedurat e vlerësimit të përcaktuara në rregullat e grantit të performancës;
- Miratimi i rezultateve të vlerësimit të performancës për GPK;
- Në rast të konstatimit të parregullsive, Komisioni mund ta kthejë në rishqyrtim procesin e vlerësimit;
- Njoftimi i komunave për rezultatet e vlerësimit për grant;
- Komisioni i grantit nuk mund të ndryshojë rezultatet e vlerësimit dhe shumat e grantit, pa aplikimin e tërësishëm të procesit të vlerësimit në pajtim me rregullat e GPK-së;
- Në rast të ndryshimit të rezultateve të vlerësimit si rezultat i vendimit për ankesë të nxjerrë nga komisioni i ankesave, komisioni i grantit përmes grupit teknik bënë ndryshimet në raportin e vlerësimit dhe njofton komunën përkatëse për rezultatit përfundimtar.

Komisioni i grantit të performancës komunale themelohet me vendim të Sekretarit të përgjithshëm të MAPL-së, përbërja e të cilit përcaktohet në nenin 35.4 të Rregullores 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Grantit të Bazuar në Performancë, si vijon:

- 1 anëtar nga MAPL (Sekretar i përgjithshëm/Kryesues),
- 1 anëtar - zyrtar publik i nivelit drejtues të ministrisë,
- 1 anëtar - zyrtar publik nga ministria përgjegjëse për financa,
- 1 vëzhgues nga Unioni Evropian në Kosovë,
- 1 vëzhgues nga Suedia,
- 1 vëzhgues nga Zvicra,
- 1 vëzhgues nga Norvegjia, dhe
- vëzhgues nga shoqëria civile.

Anëtarët e Komisionit të GPK-së nuk mund të jenë zyrtarë të përfshirë në të njëjtën kohë në Grupin Teknik dhe Komisionin e Ankesave. Anëtarët kanë të drejtë vote përderisa vëzhguesit mund të ofrojnë sygjerimet e tyre por nuk kanë të drejtë vote.

3.1.2 Grupi teknik

Grupi teknik është organ i nivelit profesional i përbërë nga zyrtarë publik të njesisë përgjegjëse për performancë komunale dhe nga përfaqësues të subjekteve kontributdhënëse.

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit teknik janë:

- Zbatimi i standardeve të vlerësimit dhe llogaritjes së performancës siç përcaktohet në rregullat e GPK-së;

- Llogaritja e shumës së grantit sipas formulës së përcaktuar në rregullat e GPK-së;
- Hartimi i raportit të vlerësimit për grant dhe adresimi për aprovim në Komisionin e GPK-së;

Grupi Teknik themelohet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-se konform nenit 34.1 të Rregullores 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Grantit të Bazuar në Performancë, përbërja e të cilit është si vijon:

- 3 anëtarë nga njësia përgjegjëse e MAPL për performancë komunale;
- 2 anëtarë nga projekti DEMOS (të cilët përfaqësojnë subjektet kontributdhënëse);
- 1 anëtar nga OJQ si vëzhgues.

3.1.3 Komisioni i ankesave

Komisioni i ankesave shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesat e parashtruara nga komunat lidhur me vlerësimin e performancës së tyre për GPK, sipas nenit 39 të Rregullores 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Grantit të Bazuar në Performancë

Detyrat e komisionit të ankesave janë:

- Shqyrtimi i ankesave për grant të parashtruara nga komunat ;
- Marrja e vendimeve për ankesat e parashtruara.

Komisioni i ankesave përbëhet nga 3 anëtarë dhe 2 vëzhgues:

- 2 përfaqësues nga MAPL (njëri prej tyre kryesues)
- 1 përfaqësues i jashtëm (nga OshC)
- 2 vëzhgues nga projekti DEMOS

Komisioni i ankesave nuk do të rishikojë ankesat që ndërlidhen me burimin e të dhënave të përdorur gjatë vlerësimit.

Anëtarët e komisioni të grantit apo grupit teknik nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të ankesave.

3.1.4. Grupi Punues për hartimin e Rregullave të GPK-së

Ky grup punues përgjegjës për hartim të Rregullave të GPK themelohet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së në bashkëpunim me kontributdhënësit.

Grupi punues është përgjegjës për:

- Përgatitjen e rregullave të GPK-së para çdo cikli të vlerësimit;
- Dërgimin e rregullave tek Sekretari i përgjithshëm i MAPL-së dhe kontributdhënësit për aprovim;

Përbërja e grupit punues themelohet sipas nenit 32.2 të Rregullores 01/2020 për SMPK dhe Skemën e Grantit të bazuar në performancë.

Grupi punues përbëhet nga 2 zyrtarë të MAPL-së (njëri kryesues) dhe 2 përfaqësues nga projekti DEMOS (si përfaqësues të kontributdhënësve).

3.2 Afati kohor

Procesi i vlerësimit të GPK-së fillon çdo vit kur të dhënat në lidhje me performancën komunale bëhen të disponueshme. Tabela më poshtë tregon afatin kohor tentativ të ndarjes së grantit për vitin 2021 sipas vlerësimit të performancës së vitit 2023.

Tabela 4: Afati kohor tentativ i procesit të vlerësimit

Aktiviteti	GPK 2023
------------	----------

Miratimi i rregullave	Gusht 2022
Mbledhja e të dhënave	Gusht 2022
Procesi i vlerësimit/pikëve	Gusht 2022
Miratimi i rezultateve të vlerësimit	Gusht 2022
Komunikimi i rezultateve tek komunat	Gusht 2022
Periudha për ankesa	Gusht - Shtator 2022
Konfirmimi i rezultateve përfundimtare dhe shumave të grantit	Shtator 2022
Transferimi i mjeteve	Janar - Shkurt 2023
Shfrytëzimi i mjeteve	VF 2023 ¹⁰

3.3 Procedurat e vlerësimit

3.3.1 Periudha e Vlerësimit për Grantin e Performancës Komunale (Ciklet e Menaxhimit të Grantit)

Periudha e vlerësimit për grantin e performancës komunale ndahet në 3 faza kryesore:

- 1.1. **Periudha e performancës** - që nënkupton vitin për të cilin vlerësohet performanca e komunës. Në bazë të këtyre rregullave të GPK 2023 vlerësohet performanca komunale e vitit 2021;
- 1.2. **Periudha e vlerësimit** - nënkupton periudhën në të cilën kryhet vlerësimi i performancës për GPK; pra performanca komunale për GPK vlerësohet në vitin 2022 për vlerësimin e performancës së vitit 2021
- 1.3. **Periudha e ndarjes dhe shfrytëzimi i grantit** - nënkupton vitin në të cilin granti vihet në dispozicion për shfrytëzim nga komunat. Në bazë të këtyre rregullave granti do të jetë në dispozicion për komunat në vitin 2023.

3.3.2. Përgatitjet për vlerësim të GPK-së

Procedurat përgatitore për vlerësim të GPK-se, janë si vijon:

- Grupi Punues përgjegjës për hartimin e Rregullave të GPK-së përgatit rregullat e GPK-së për vitin fiskal 2023 (viti i alokimit) për performancën e komunave të vitit 2021.
- Rregullat e hartuara i dorëzohen Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së dhe kontributdhënësve.
- Rregullat e GPK-së para vlerësimit autorizohen (miratohen) nga Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së dhe Kontributdhënësit e Grantit.
- Pas aprovimit, Rregullat e GPK-së i'u shpërndahen komunave dhe publikohen në uebfaqen e MAPL.
- Procesi i vlerësimit fillon sipas afatit kohor të përcaktuar në tabelën 4 të këtyre rregullave.

3.3.3. Mbledhja dhe vlerësimi i të dhënave

Grupi teknik mbledh të dhënat për vlerësimin e grantit të performancës komunale. Këto të dhëna burojnë nga dokumentet e mëposhtme:

- 1) Raporti i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2021 (SMPK) i MAPL-së, i publikuar nga MAPL;
- 2) Raporti i funksionimit të komunave të Kosovës për vitin 2021 i publikuar MAPL-së

¹⁰ Pjesa e fondeve të GPK e financuar nga donatorët mund të shfrytëzohet gjatë vitit 2023 dhe 2024.

- 3) Raportet e auditimit të rregullsisë për vitin 2021 për secilën prej 38 komunave, të publikuara nga ZKA;

Të dhënat e përdorura nga këto burime mundësojnë identifikimin e komunave të cilat katër kushtet minimale për grantin e performancës komunale (shih Shtojcën 1). Të dhënat po ashtu përdoren për të vlerësuar treguesit e GPK-së (shih Shtojcën 2). Pas kësaj, fletëvlerësimi (shih shabllonin në shtojcën 3) do të plotësohet me rezultatet për çdo komunë. Pikët totale do të regjistrohen në tabelën e ndarjes së grantit, e cila do të llogarisë shumën e grantit të performancës komunale për secilën komunë që është kualifikuar (shtojca 4).

3.3.4. Komunikimi i rezultateve të komunave dhe procedura e ankesës

Pasi që Komisioni i GPK-së të ketë miratuar rezultatet e vlerësimit për GPK, brenda 7 ditësh, komunikon fletëvlerësimet në komuna. Komunikimi i rezultateve të performancës së komunës përkatëse bëhet vetëm për dhënie të informatës nëse komuna është kualifikuar ose jo, si dhe pikëve të performancës për GPK. Shumat dhe rangimi i komunave do të komunikohen vetëm pas përmbylljes së procesit të ankesave.

Me rastin e komunikimit të rezultateve, komunat kanë të drejtë të ankohen brenda **7 ditësh nga momenti i pranimit të fletëvlerësimit nga ministria**, në rast se nuk pajtohen me rezultatet e vlerësimit.

Ankesa mund të parashtrohet nga komunat për arsye procedurale dhe materiale të vlerësimit të GPK-së.

Ankesa nuk mund të kundërshtojë burimin e të dhënave zyrtare të përdorura gjatë vlerësimit.

Nëse një komunë, pretendon se organet përgjegjëse për GPK kanë bërë gabime në vlerësimin e performancës së saj, mund të shfrytëzoj të drejtën e ankesës sipas procedurave të mëposhtme:

Hapat dhe afatet kohore në një proces ankimi		
1.	Nëse, pas marrjes së fletëvlerësimit, komuna është e mendimit se janë bërë gabime procedurale ose materiale në vlerësimin për grantin e performancës, komuna ka të drejtë të parashtrij ankesë te komisioni i ankesave. Ankesa duhet të: <ul style="list-style-type: none"> • Arsyetohet me të dhëna faktike; • Nënshkruhet nga kryetari i komunës dhe të jetë e protokoluar; • Dorëzohet me shkrim në: Komisionin e ankesave Ministria e Pushtetit Lokal E-mail: info.mapl@rks-gov.net Pas dorëzimit të ankesës, MAPL konfirmon me shkrim pranimin e ankesës. 	Brenda 7 ditësh nga marrja e fletëvlerësimit, para orës 16:00
2.	Komisioni i ankesave i shqyrton ankesat dhe merr vendim lidhur me ankesat e parashtruara.	Brenda 7 ditësh pas mbylljes së afatit të ankesës

3	Në rast të ndryshimit të rezultateve të vlerësimit si rezultat i Vendimit të Komisionit të ankesave, Komisioni i GPK-së, përmes Grupit Teknik, bën ndryshimin e raportit të vlerësimit dhe e njofton komunën	Brenda 14 ditësh pas vendimit të Komisionit të ankesave
---	--	---

Në rast se një ankesë e një ose më shumë komunave rezulton e suksesshme dhe ndikon në ndryshimin e rezultateve të GPK-së, kjo do të ketë ndikim në shumën e grantit të komunave tjera. Të gjitha ndryshimet në ndarjen e grantit pas procesit të ankesave, miratohen nga Komisioni i GPK-së.

3.3.5. Finalizimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit dhe ndarja e grantit

Pasi që komisioni i ankesave të ketë vendosur për ankesat, Komisioni i GPK-së përmes grupit teknik i bën ndryshimet në raportin e vlerësimit si dhe ndarja pasuese e grantit të performancës komunale konsiderohet përfundimtare.

Rezultatet përfundimtare dhe shumat e grantit do të komunikohen tek komunat në mënyrë që ato të mund të planifikojnë shfrytëzimin e grantit të performancës komunale.

MAPL e publikon raportin përfundimtar të vlerësimit të performancës në ueb-faqen e saj.

3.3.6. Masat për sigurimin e vlerësimit objektiv

Ekziston rreziku për gabime gjatë procesit të vlerësimit të komunave për GPK. Kjo nënkupton që vlerësimi joobjektiv të ndikoj në shpërndarjen jomeritore të grantit të performancës.

Për të evituar këtë rrezik, Rregullorja për SMPK-së si dhe Rregullat e Grantit për performancë përcaktojnë mekanizmat e sigurimit të cilësisë si vijon:

- Procesin e verifikimit - i cili mundëson krahasimin e të dhënave të raportuara me dokumentet ose faktet që dëshmojnë vërtetësinë;
- Zbatimin e procedurave të ankesave si në rastin e hartimit të raportit të performancës, ashtu edhe në procesin e vlerësimit për GPK.
- Përfshirjen e kontributdhënësve në të gjitha proceset e vlerësimit të performancës dhe GPK-së;
- Përfshirjen aktive të shoqërisë civile në cilësinë e vendimarrësve (në komisionin për ankesa të GPK) si dhe në cilësinë e vëzhguesve në Komisionin e GPK-së dhe mundësisht në Grupin Teknik;
- Verifikimin e cilësisë së alokimit të grantit nga konsulentë të jashtëm (opsionale).
- Mundësinë e shpalljes së pavlefshme të të dhënave të performancës në rastet e mospërmbushjes së kriterëve të cilësisë (neni 21 i Rregullores për SMPK) konform Metodologjisë përkatëse;

4. Shtojcat

Shtojca 1: Udhezuesi për vlerësim – Kushtet minimale

#	Kushti minimal	Përkufizimi i kushtit minimal	Baza ligjore	Burimi i të dhënave	Kriteri Komuna i ka përbushur / nuk i ka përbushur
1	Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar;	Komunat duhet të kenë raportuar për performancën e tyre në SMPK sipas afatit të përcaktuar në Rregulloren për performancë	Rregulloria no.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, neni 13	Raporti i SMPK-së 2021, MAPL	Po, nëse komuna ka raportuar me kohë në SMPK Jo, Nëse komuna nuk ka raportuar me kohë SMPK.
2	Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës	Komunat duhet t'i kenë rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme në vitin 2020 nga autoriteti mbikëqyrës. Rishqyrtimi për qëllime të Grantit të Performancës Komunale është kriter procedural, që nënkupton obligimin e komunës për të rishqyrtuar në Kuvendin e Komunës aktin e vlerësuar si të kundërligjshëm nga autoriteti mbikëqyrës, pa presupozuar përmbajtjen përfundimtare të aktit të rishqyrtuar.	Ligji nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale	Raporti i funksionimit të komunave të Kosovës për vitin 2021, i publikuar nga MAPL dhe Raporti për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të kuvendeve komunale 2021	Po, nëse komuna ka kryer rishqyrtimin e akteve ligjore nga kuvendi komunal Jo, nëse komuna nuk ka kryer rishqyrtimin e akteve ligjore nga kuvendi komunal
3	Opinionet e auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes;	Opinionet e vjetor i auditimit së paku i pamodifikuar me theksim të çështjes ¹¹	1. Ligji nr.03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (LMFPP) 2. Rregullorja nr.01/2017 për raportimin vjetor financiar nga organizatat buxhetore e nxjerrë nga	Raportet individuale të auditimit të rregullsisë për	Po, nëse Komuna merr Opinion të pamodifikuar ose Opinion të Pamodifikuar me theksim të çështjes;

¹¹ ZKA ofron lloje të ndryshme të opinionëve:

4	Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale	Të paktën 75% e buxhetit final për investime kapitale i shpenzuar	MF-ja. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik 1. Rregulli financiar nr.01-2013 i LMFP-së për shpenzimet e parasë publike	vitin 2021, të publikuara nga ZKA Raportet individuale të auditimit të rregullisë për vitin 2021, të publikuara nga ZKA	Jo, nëse komuna merr <i>Opinion të Kualifikuar ose të Kundërt, dhe nëse ZKA refuzon dhënien e opinionit</i> Po, në qoftë se komuna ka shpenzuar së paku 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale Jo, në qoftë se komuna ka shpenzuar më pak se 75% të buxhetit final për investime kapitale
---	---	---	---	--	--

Opinion i pamodifikuar:

- Nëse konstatohet se janë përgatitur pasqyrat financiare, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën financiare në fuqi

Opinion i kualifikuar:

- Nëse posedon dëshmi të mjaftueshme të auditimit të duhur, auditori konstaton se gabimet, individualisht ose në tërësi, janë materiale, por jo të përhapura, në pasqyrat financiare; ose
- Nëse auditori nuk ishte në gjendje të siguronte dëshmi të mjaftueshme të auditimit të duhur mbi të cilën do të bazonte një opinion, por konkludon se efektet në pasqyrat financiare të çdo gabimi të pazbuluar mund të jenë materiale por jo të përhapura

Opinion i kundërt:

- Nëse posedon dëshmi të mjaftueshme të auditimit të duhur, auditori konstaton se gabimet, individualisht ose në tërësi, janë si materiale ashtu edhe të përhapura në pasqyrat financiare

Refuzon dhënien e Opinioneit :

- Nëse nuk ka qenë në gjendje të posedoj dëshmi të mjaftueshme të auditimit të duhur mbi të cilën do ta bazonte opinionin, auditori konstaton se efektet në pasqyrat financiare të çdo gabimi të pazbuluar mund të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka vendosur një kufizim në fushëveprimin e auditimit të cilën auditori e konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose refuzon dhënien e një opinionin mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë që menaxhmenti ta heq kufizimin.

Theksimi i çështjes:

- Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesit në një çështje të paraqitur ose të shpalosur në pasqyrat financiare që është e një rëndësie të tillë që është thelbësore për ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ekziston dëshmi e mjaftueshme adekuate se çështja nuk është materialisht e gabuar në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e theksimit të çështjes në raportin e auditorit. Paragrafi me Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose të shpalosur në pasqyrat financiare.

Shtojca 2: Udhëzuesi për vlerësim – Treguesit e performancës

Tabela më poshtë paraqet 30 treguesit e performancës. Mënyra se si maten treguesit nga SMPK, është përshkruar në dokumentet e SMPK-së. Në tabelën më poshtë janë dhënë përkufizimet e shkurtëra se si maten treguesit. Treguesit: nr. 3, nr. 19 dhe nr. 27 nuk merret për bazë në vlerësimin për performancën e vitit 2021 të GPK për vitin fiskal 2023.

#	Treguesi	Përkufizimi i shkurtër
I. QEVERISJA DEMOKRATIKE		
1	Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	
1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	Treguesi mat nivelin e përbushjes së detyrimit ligjor nga ana e organeve komunale për të hartuar dhe dorëzuar propozimin e buxhetit komunal për miratim, dhe miratimin e tij nga kuvendi komunal. Propozimi vjetor i buxhetit komunal për vitin n+1 duhet të dorëzohet në KK më 1 shtator, më së voni. Propozimi i buxhetit duhet të miratohet nga KK-ja dhe të dorëzohet në Ministrinë e Financave më 30 shtator, më së voni. Baza ligjore lidhur me hartimin dhe miratimin e propozimit vjetor të buxhetit është dhënë nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Matja e performancës së këtij treguesi bazohet në matjen e: i) dorëzimit me kohë të propozimit të buxhetit komunal në KK dhe ii) dorëzimit me kohë të propozimit të miratuar të buxhetit komunal në Ministrinë e Financave.
2	Diskutime për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	Treguesi mat përbushjen e detyrimit ligjor nga ana e autoriteteve komunale për t'i paraqitur dhe për t'i diskutuar raportet tremujore buxhetore në kuvendin komunal. Raportet buxhetore duhet të dorëzohen për diskutim çdo tre muaj në kuvendin komunal, d.m.th., raportet duhet të dorëzohen në kuvendin komunal nga kryetari i komunës. Baza ligjore për përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve tremujore buxhetore në KK është dhënë në Ligjin për Menaxhimin të Financave Publike dhe Përgjegjësisë. Matja e performancës së këtij treguesi bazohet në matjen e paraqitjes në kohë të raporteve tremujore (brenda 30 ditëve nga përfundimi i tremujorit) nga ana e kryetarit të komunës para KK-së, për secilin tremujor, duke vëzhguar respektimin e datave: 31 janar, 30 prill, 31 korrik dhe 31 tetor të vitit fiskal të vlerësuar.
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin paraprak	Treguesi mat përbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e komunës për t'i paraqitur dhe për t'i diskutuar rezultatet e performancës vjetore komunale nga Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) në KK. Për qëllime vlerësimi, Raporti Komunal i

		<p>Performancës (viti n-1) duhet të jetë pikë e rendit të ditës në një nga mbledhjet e KK-së para qershorit (viti n).</p> <p>Përmes këtij treguesi, KK-ja është në gjendje të diskutojë çdo vit dhe ta mbajë ekzekutivin llogaridhënës për punën e komunës. Matja e performancës së këtij treguesi bazohet në matjen e paraqitjes në kohë të raportit, në mënyrë specifike kërkohet të dëshmohet si vërtetim se raporti i SMPK-së është përfshirë si nëntitull raportues në rendit e ditës së kuvendit komunal pas publikimit të raportit; me vitin kalendarik kur publikohet raporti.</p>
4	<p>Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal</p>	<p>Për skemën e grantit, ky tregues grumbullon leximet nga dy tregues të SMPK-së, gjegjësisht treguesi 3.2.4 dhe treguesi 3.2.5;</p> <p>Treguesi 3.2.4 mat performancën komunale në lidhje me përbushjen e obligimit për të paraqitur Raportin Kombëtar të Auditimit para KK-së për diskutim, përfshirë edhe planin e veprimit. Baza ligjore për këtë paraqitje është dhënë në Ligjin për ZKA-në, duke ua vendosur detyrimin autoriteteve komunale që të raportojnë në KK për aktivitetet e planifikuara dhe të ekzekutuara në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e ZKA-së të specifikuara në Raportet e tyre Vjetore të Auditimit të Rregullisë; Matja e performancës bazohet në kriteret e mëposhtme: i) diskutimi i raportit të ZKA-së në KK dhe ii) diskutimi i planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së; kërkohen dëshmi specifike për të konfirmuar plotësimin e kriterëve brenda afatit të përcaktuar.</p> <p>Treguesi 3.2.5 mat performancën komunale në lidhje me paraqitjen për diskutim të raportit të Auditimit të Brendshëm para KK-së, përfshirë planin e veprimit në lidhje me gjetjet. Matja e performancës bazohet në kriteret e mëposhtme: i) diskutimi i raportit të Auditimit të Brendshëm në KK dhe ii) diskutimi i planit të veprimit për t'i adresuar rekomandimet e raportit të Auditimit të Brendshëm; kërkohen dëshmi specifike për të konfirmuar plotësimin e kriterëve brenda afatit të përcaktuar.</p> <p>Treguesi mat performancën komunale në lidhje me detyrimin e kryetarëve të komunave për të raportuar në KK, duke matur pjesëmarrjen e kryetarëve të komunave në mbledhjet e kuvendit të komunës. Matja e performancës bazohet në dëshmitë që vërtetojnë praninë e kryetarit të komunës në seancat e punës të KK-së, konkretisht listat e pjesëmarrjes ose raportet e mbledhjeve të KK-së.</p>
5	<p>Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës</p>	
II	<p>Pjesëmarrja, konsultimi i qytetarëve dhe gjithëpërfshirja</p>	
6	<p>Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike, i disgreguar sipas gjinisë</p>	<p>Për skemën e grantit, ky tregues grumbullon leximet nga dy tregues të SMPK-së, gjegjësisht treguesi 3.1.2 dhe treguesi 16.1.3.</p>

		<p>Treguesi 3.1.2. mat nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në të gjitha konsultimet publike komunale në raport me numrin e banorëve në komunë. Shkalla e pjesëmarrjes maksimale për këtë tregues konsiderohet 3% e numrit të banorëve të komunës përkatëse. Matja e performancës për këtë tregues merr në konsideratë si në vijim: të gjitha aktivitetet e konsultimit publik; përfshirë takimet publike, seancat dëgjimore të buxhetit dhe konsultimet për aktet komunale.</p> <p>Treguesi 3.1.3. mat pjesëmarrjen e grave në konsultimet publike si përqindje e të gjithë pjesëmarrësve në aktivitetet e konsultimit publik; Ky është një tregues i barazisë gjinore, i nxjerrë nga pjesëmarrja e përgjithshme e qytetarëve në konsultimet publike.</p> <p>Treguesi mat performancën në lidhje me nivelin e përmbushjes së detyrimit nga ana e kuvendit komunal sa i përket konsultimit publik gjatë hartimit të akteve të përgjithshme. Për qëllime të këtij treguesi, bazuar në përcaktimin në nenin 8 të Udhëzimit Administrativ 01/2015, publiku konsultohet për sa i përket akteve të përgjithshme të cilat miratohen nga KK. Matja e performancës për këtë tregues bazohet në dëshmitë në vijim: (i) numri i akteve të përgjithshme dhe i dokumenteve të politikave të miratuara gjatë vitit, dhe (ii) numri i akteve të përgjithshme dhe i dokumenteve të politikave të miratuara gjatë vitit, e të cilat kanë kaluar nëpër konsultimin publik.</p> <p>Treguesi mat performancën e komunës në organizimin e seancave dëgjimore për KAB-in dhe për buxhetin, duke përdorur numrin prej 10.000 banorëve si referencë për numrin e popullsisë së komunës, që nënkupton përcaktimin e numrit të seancave dëgjimore në raport me numrin e popullsisë. Për komunitet me 10.000 banorë ose më pak, numri minimal i seancave dëgjimore caktohet në 2 seanca. Konteksti ligjor për këtë tregues është nxjerrë nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Udhëzimi Administrativ për transparencë komunale, si dhe nga Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Matja e performancës për këtë tregues bazohet në dëshmitë dokumentuese për kriteret e mëposhtme: (i) numri i konsultimeve publike për buxhetin vjetor komunal (ii) numri i konsultimeve publike për KAB-in; (iii) numri i banorëve në komunë.</p>
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	
8	Dëgjime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe buxhet komunal (proporcionalisht ndaj # banorëve)	
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	
9	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	<p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në njoftimin me kohë të mbledhjeve të KK-së dhe në ofrimin e transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të KK-së dhe të komiteteve të saj. Transmetimi online konsiderohet gjithashtu transmetim për qëllimet e këtij treguesi, duke parashikuar që transmetimi online është në dispozicion në faqen zyrtare të komunës. Baza ligjore për këtë tregues është dhënë në Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna. Nivelin e performancës së treguesit bazohet në dëshmitë dokumentuese në lidhje me kriteret e</p>

		<p>mëposhtme: (i) numri i mbledhjeve të KK-së; (ii) numri i njoftimeve për mbledhjet e KK-së; (iii) numri i mbledhjeve të KK-së që janë transmetuar drejtpërdrejt.</p> <p>Treguesi mat nivelin e performancës së autoriteteve përgjegjëse komunale në menaxhimin e uebfaqes, duke siguruar përmbajtje të specifikuar dhe përditësim të rregullit. Kriteret për përmbajtjen e uebfaqes komunale janë dhënë në Udhëzimin Administrativ (MAP) nr. 01/2015, duke specifikuar përmbajtjen e domosdoshme (popullimin e uebfaqes) për uebfaqet e institucioneve publike, si dhe në Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 04/2018. Për qëllimet e këtij treguesi, matja e performancës i nënshtrohet dëshmiave dokumentuese të plotësimit të një liste të përcaktuar me 8 kriteret.</p> <p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në lidhje me respektimin e rregulloreve të kërkuara për publikimin e dokumenteve të prokurimit publik, planit vjetor të prokurimit, raportit për zbatimin e planit të prokurimit në periudhën e paraparë, kontratave publike;</p> <p>Treguesi llogaritet duke dhënë pikë për pajtueshmëri me secilën nga 3 kategoritë (publikimi i dokumenteve). Ky është një tregues i rëndësishëm për transparencën, duke lejuar mbikëqyrjen publike dhe llogaridhënien në lidhje me menaxhimin e fondeve publike nga autoritetet komunale. Performanca e këtij treguesi bazohet në dëshmitë në dispozicion për të përcaktuar pajtueshmërinë në lidhje me: (i) publikimin e planit vjetor të prokurimit publik; (ii) publikimin e raportit për zbatimin e planit të prokurimit publik; (iii) publikimi i kontratave publike.</p> <p>Treguesi mat % e proceseve të konsultimeve publike të cilat pasohen me një raport brenda afatit kohor ku listohen kërkesat e qytetarëve dhe grupeve të interesit si dhe sqarimet për refuzimin e kërkesave të tyre, sipas U.A. për standardet minimale të konsultimit publik.</p> <p>Treguesi është i rëndësishëm për të monitoruar llogaridhënien e autoriteteve komunale ndaj zonës elektorale të tyre, duke ua mundësuar qytetarëve që t'i monitorojnë inputet e tyre, dhe duke i mbajtur autoritetet komunale llogaridhënese. Performanca e treguesit matet në dy kriteret: (i) numri i konsultimeve publike gjatë vitit; dhe (ii) numri i konsultimeve publike kur raporti është ngarkuar në uebfaqen komunale brenda 30 ditëve.</p> <p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në lidhje me përmbushjen e detyrimit për të raportuar mbi zbatimin e planit të integritetit gjatë vitit të vlerësuar, duke siguruar në thelb transparencën dhe llogaridhënien për masat kundër korrupsionit të parapara me planin e integritetit, si instrument parandalues kundër korrupsionit. Performanca e këtij treguesi vlerësohet bazuar në dëshmitë që ofrojnë informata se raporti vjetor i zbatimit të Planit të Integritetit është paraqitur dhe është diskutuar nga KK-ja gjatë vitit deri më 31 dhjetor.</p>
10	Përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	
11	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	
12	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	

II. MENAXHIMI KOMUNAL

IV	Menaxhimi financiar	<p>14</p> <p>Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë</p>	<p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale sa i përket zbatimit të detyrimit që lidhet me rivlerësimin e ndërtesave për qëllime të tatimit në pronë brenda vitit kalendarik. Rivlerësimi i ndërtesave për qëllime të tatimit në pronë i referohet detyrimit për t'i identifikuar dhe regjistruar ndryshimet në ndërtesat ekzistuese, në mënyrë që të mundësohet fakturimi i tatimit në pronë siç kërkohet me ligj, dhe duhet të kryhet çdo vit. Ligji përcakton që 20% e pronave (ndërtesave) duhet të rishikohen për qëllime të verifikimit, në mënyrë që të sigurohet konsistencë midis regjistrimit dhe gjendjes aktuale të pronës. Baza ligjore për këtë tregues është Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Performanca e treguesit llogaritet bazuar në informacionin e marrë në lidhje me: (i) numrin e pronave (ndërtesave) në komunë; (ii) numrin e pronave (ndërtesave) në komunë që janë verifikuar.</p>
15	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	<p>15</p> <p>Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)</p>	<p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në zbatimin e detyrimit të tyre ligjor në lidhje me arkëtimin e tatimit në pronë, e shprehur si përqindje e totalit të tatimit në pronë të faturuar brenda një viti. Treguesi llogaritet normën e arkëtimit në një vit, duke përjashtuar borxhet nga faturat e vitit të kaluar, pagesat e interesit dhe gjokat. Matja e nivelit të arkëtimit të tatimit në pronë i referohet vitit të vlerësuar. Ky tregues vlerëson autoritetet komunale duke matur nivelin e arkëtimit të tatimit në pronë në krahasim me tatimin e faturuar gjatë vitit të vlerësuar. Baza ligjore për këtë tregues është Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Performanca e treguesit llogaritet bazuar në informacionin e marrë në lidhje me: (i) shumën e faturuar për totalin e tatimit në pronë për atë vit (ii) shumën e arkëtuar për totalin e tatimit në pronë të faturuar për atë vit. Treguesi nuk mat vlerën totale të tatimit në pronë të arkëtuar, pasi shuma totale mund të përfshijë edhe borxhet më të vjetra të transferuara nga vitet e kaluara, pagesat e interesit dhe gjokat; në mënyrë specifike ai mat vetëm nivelin e tatimit të arkëtuar gjatë vitit raportues.</p>
16	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	<p>16</p> <p>Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit</p>	<p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në lidhje me zbatimin dhe adresimin e plotë të rekomandimeve të nivelit të lartë dhe të mesëm, të paraqitura shprehimisht në raportin e auditimit të ZKA-së. Në raportin e auditimit të ZKA-së (n-2), i cili i referohet vitit fiskal (n-3), paraqiten rekomandime për zbatim ose adresim, të cilat duhet të zbatohen dhe adresohen plotësisht në vitin (n-1). Treguesi është një masë e rëndësishme e reagimit të autoriteteve komunale në lidhje me rekomandimet e dhëna nga ZKA-ja. Performanca e treguesit vlerësohet bazuar në dëshmitë e adresimit të rekomandimeve të listuara, si përqindje e rekomandimeve të adresuara në raport me rekomandimet e listuara.</p>

V	Menaxhimi i kontratave	Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në lidhje me zbatimin e planit vjetor të prokurimit komunal, duke vlerësuar performancën bazuar në nivelin e shpenzimit të buxhetit të planifikuar, përmes aktiviteteve të prokurimit. Në mënyrë të veçantë, treguesi përdor informacion financiar për të vlerësuar performancën ndërmjet buxhetit të planifikuar dhe atij të ekzekutuar përmes prokurimit. Treguesi është një masë e rëndësishme e efektivitetit dhe efikasitetit të autoriteteve komunale në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit përmes njësisë së prokurimit publik, duke siguruar respektimin e ligjeve, rregullave dhe rregullore të prokurimit. Performanca e treguesit vlerësohet bazuar në dëshmitë dokumentuese në vijim: (i) buxheti i përgjithshëm i shpenzuar përmes prokurimit; (ii) buxheti i përgjithshëm i planifikuar për aktivitetet e prokurimit.
17	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në përbushjen e detyrimeve të tyre në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, posaçërisht në përgatitjen dhe publikimin e listës së pronave të planifikuara për t'i dhënë në shfrytëzim për palët e interesuara, konform Ligjit për dhenien në shfrytëzim dhe këmblimin e pronës së paluajtshme të komunës. Performanca e treguesit bazohet në dëshmitë që ofrojnë informata për kriteret e mëposhtme: (i) lista e përgatitur dhe përditësuar me prona të planifikuara për dhënie në shfrytëzim; (ii) publikimi i listës së përditësuar të pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim.
18	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	
19	Vende të hapura të punës që janë procesuar përmes SIMBNJ	Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale për të siguruar pajtueshmërinë me menaxhimin e burimeve njerëzore në komunë, duke siguruar që të gjitha vendet e lira të punës përpunohen përmes sistemit elektronik SIMBNJ (sistemi informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore). Performanca e treguesit vlerësohet duke u bazuar në informatat e dhëna për: (i) numrin e përgjithshëm të punësimeve të reja të nëpunësve civilë gjatë vitit, në komunë dhe në institucionet vartëse të saj; (ii) numrin e përgjithshëm të punësimeve të reja të nëpunësve civilë gjatë vitit në komunë dhe në institucionet vartëse të saj, të përpunuara përmes SIMBNJ-se.
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	Treguesi mat nivelin e performancës së autoriteteve komunale në lidhje me nivelet e arritura të barazisë gjinore në pozitave udhëheqëse në institucionet vartëse të komunës në fushën e arsimit, kujdesit shëndetësor, kulturës dhe sportit. Treguesi mat përqindjen e pajtueshmërisë me cakun e barazisë gjinore, duke matur përqindjen e grave në pozita më të larta menaxhuese në organet komunale dhe institucionet vartëse. Baza ligjore për këtë tregues është Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, dhe Programi i Kosovës për Barazi Gjinore. Performanca e treguesit përcaktohet në bazë të dëshmitë (i) totali i të

		<p>punësuarve në pozitat më të larta menaxhuese në organet komunale dhe institucionet vartëse, (ii) numri i grave në pozitat e larta menaxhuese në organet komunale dhe institucionet vartëse.</p> <p>Treguesi mat nivelin e performancës së autoriteteve komunale në lidhje me nivelet e arritura të barazisë gjinore në pozitat politikisht të emëruara në strukturat e komunës. Treguesi mat përqindjen e pajtueshmërisë me cakun e barazisë gjinore, duke matur përqindjen e grave në pozitat politikisht të emëruara në autoritetet komunale. Treguesi mat emërimet në pozita politike siç është pozita e nënkryetarit të komunës, drejtorit komunal, këshilltarit politik dhe pozitave të tjera politikisht të mandatuara. Baza ligjore për këtë tregues është Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Programi i Kosovës për Barazi Gjinore. Performanca e treguesit përcaktohet në bazë të dëshmi (i) totali i personave në pozita politike të emëruara në komunë (ii) numri i grave në pozitat politike të emëruara në komunë.</p>
21	Gra të emëruara në postet politike në komunë	
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE		
VII Shërbimet administrative		
22	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	<p>Treguesi mat efektivitetin e autoriteteve komunale në shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga qytetarët dhe organizatat përgjatë vitit të vlerësuar. Prandaj, autoritetet komunale obligohen t'i shqyrtojnë të gjitha kërkesat e qytetarëve brenda afateve specifike, varësisht nga natyra/fusha e kërkesës. Vetëm rastet e regjistruara (dorëzuar) përmes Qendrës Komunale për Qytetarët merren parasysh dhe llogariten për qëllimet e matjes. Treguesi mat përqindjen e rasteve të shqyrtuara në raport me rastet e përgjithshme të menaxhuara nga sistemi komunal. Baza ligjore për treguesin është Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe një grup i gjerë ligjesh dhe aktesh nënligjore që rregullojnë kohëzgjatjet specifike të procedurave. Performanca e treguesit vlerësohet duke siguruar informata në lidhje me: (i) numrin e rasteve të shqyrtuara nga komuna gjatë vitit; (ii) numrin e rasteve të shqyrtuara nga komuna brenda afateve ligjore.</p>
23	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	<p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në lidhje me efektivitetin e shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimore. Në mënyrë të veçantë, ky tregues mat përqindjen e kërkesave të shqyrtuara, pa paragjykuar rezultatit pozitiv ose negativ të kërkesave për leje ndërtimore, meqenëse kualifikueshmëria ose pajtueshmëria e secilës kërkesë ose ndonjëris prej tyre për leje ndërtimore nuk mund të paragjykohej. Përqindja e kërkesave të shqyrtuara bazohet në numrin e kërkesave të paraqitura gjatë vitit të raportuar. Baza ligjore për këtë tregues është Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Performanca e treguesit vlerësohet bazuar në dëshmitë e</p>

		disponueshme për kriteret vijuese: (i) numrin e kërkesave për leje ndërtimore përgjatë vitit; (ii) numrin e kërkesave të shqyrtuara përgjatë vitit.
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	
24	Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme) ose harta zonale	Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në përmblajtjen e mandatit të tyre për të krijuar dhe zbatuar instrumente ligjore që rregullojnë përdorimin e tokës, siç janë planet e detajuara rregullative. Në mënyrë të veçantë, treguesi mat përqindjen e territorit komunal që është i përfshirë në planet e detajuara rregullative ose hartat zonale si instrumente ligjore që rregullojnë përdorimin e tokës. Performanca matet si përqindje e territorit që është i përfshirë në hartat zonale ose planet e detajuara rregullative. Baza ligjore për këtë tregues është Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor. Nivellet e performancës së treguesit bazohet në dëshmitë e siguruarra për kriteret vijuese: (i) sipërfaqen e përgjithshme të komunës në ha; (ii) sipërfaqen e përgjithshme të komunës që është e përfshirë në instrumente planifikimi siç është Plani i Detajuar Rregullativ ose Harta Zonale në ha.
25	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	Treguesi mat performancën e komunës në lidhje me organizimin e shërbimeve të transportit publik për secilin vendbanim në komunë dhe në të mirë të qytetarëve të saj. Performanca matet si përqindja e vendbanimeve që përfshihen në sistemin e transportit publik në lidhje me numrin e përgjithshëm të vendbanimeve në komunë. Baza ligjore për këtë tregues është dhënë në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin nr. 04/L-179 për Transport Rrugor. Performanca e treguesit vlerësohet duke u bazuar në dëshmitë në lidhje me kriteret vijuese: (i) numrin e vendbanimeve në komunë; (ii) gjithsej vendbanime të përfshira në transportin lokal publik.
26	Realizimi i planit lokal të veprimit në mjedis	Treguesi mat performancën e komunave në përgatitjen dhe zbatimin e planeve lokale të veprimit, të cilat paraqesin planet e domosdoshme lokale të veprimit për mbrojtjen e mjedisit. Performanca matet me zbatimin e aktiviteve vjetore të përcaktuara në plan. Si rezultat, matja e performancës në hartimin e dokumentit të planifikimit për planin e veprimit për mbrojtjen e mjedisit matet gjithashtu përmes zbatimit. Baza ligjore për këtë tregues është dhënë në Ligjin nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Performanca e treguesit vlerësohet duke u bazuar në informatat në dispozicion në lidhje me kriteret vijuese: (i) aktivitetet e planifikuara për veprim lokal/komunal mjedisor; (ii) aktivitetet e realizuara nga veprimet e planifikuara.
IX	Arsimi para-universitar	
27	Fëmijët që vijnë kopshtin - rura dhe përgjithësi	Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në rritjen e numrit të fëmijëve që vijnë kopshtet e fëmijëve si pjesë e edukimit të hershëm. Treguesi jep përqindjen e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç që vijnë kopshte fëmijësh, e matur për fëmijët e asaj

		<p>grupmoshe në komunë dhe për fëmijët në zonat rurale. Për komunën, sfida është t'i ndërtojë dhe t'i drejtojë kopshtet e fëmijëve për ta përbushur kërkesën e popullatës. Treguesi gjithashtu mbledh të dhëna të ndara sipas gjinisë së fëmijëve/vijueshmërisë së vajzave. Performanca e treguesit vlerësohet nga dëshmitë në lidhje me kriteret vijuese:</p> <p>(i) numrin e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç nga totali i fëmijëve, nga zonat rurale dhe numrin e vajzave; (ii) numrin e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç që janë të regjistruar në kopshte fëmijësh në total, nga zonat rurale, dhe numrin e vajzave.</p>
28	Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12	<p>Treguesi mat shkallën e përgjithshme të kalueshmërisë së pragut të kërkuar si kusht për njohjen e kalimit të provimit të maturës shtetërore, përkatësisht vlerësohen arritjet në mësim nxënie të nxënësve në nivelin e përfundimit të klasës së 12-të/, respektivisht në nivel të mesëm të lartë.</p> <p>Në fund të klasës së 12-të, nxënësit i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore me prag kalueshmërie 40% dhe nxënësit që e kalojnë këtë provim kanë të drejtë të vazhdojnë arsimin e lartë. Baza ligjore për këtë tregues është Ligji nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore. Performanca e treguesit vlerësohet në bazë të përqindjes së nxënësve që kanë arritur mbi 40% të rezulttit në provim. Në mënyrë të veçantë, dëshmitë janë të nevojshme për kriteret vijuese: (i) numrin e nxënësve që kanë përfunduar klasën e 12-të, të ndarë sipas gjinisë; dhe (ii) numrin e nxënësve që kanë përfunduar testin me rezultat 40% ose më të lartë, të ndarë sipas gjinisë.</p>
X	Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH)	
29	m ² të hapësirave të kujdesit primar shëndetësor për 10000 banorë	<p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale në lidhje me ndërtimin dhe drejtimin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor, bazuar në numrin e popullsisë në komunë. Në mënyrë të veçantë, treguesi mat sipërfaqen e përgjithshme të disponueshme të KPSH-së në m² për 10.000 banorë, duke siguruar raportin e dendësisë së infrastrukturës së disponueshme me numrin e popullsisë. Baza ligjore për kompetencat komunale për kujdesin parësor shëndetësor është dhënë në Ligjin nr. 04-L-125 për Shëndetësi. Performanca në këtë tregues vlerësohet duke u bazuar në dëshmitë mbi këto kriterë:</p> <p>(i) gjithsej numri i banorëve në komunë</p> <p>(ii) gjithsej sipërfaqet të institucioneve të KPS-së;</p>

30	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjarë dhe 2 infermierë për 2000 banorë	<p>Treguesi mat performancën e autoriteteve komunale për të siguruar pajtueshmëri në lidhje me raportin e synuar prej 1 ekipe të mjekësisë familjare (1 mjek familjar dhe 2 infermierë) për 2000 njerëz. Treguesi matet si përqindje e pajtueshmërisë së raportit të tanishëm të ekipeve të disponueshme të mjekësisë familjare në krahasim me raportin e synuar. Raporti specifik i synuar është krijuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe është dhënë në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017. Vlera e performancës së treguesit përcaktohet duke u bazuar në dëshmitë për kriteret vijuese: (i) Gjithsej numri i ekipeve të mjekësisë familjare në komunë; (ii) Numri i banorëve në komunë.</p>
----	---	--

Shtojca 3: Shablloni i fletëvlerësimit dhe udhëzuesi i pikëve

Përmbledhje e rezultateve për vitin 2021 për grantin e performancës komunale - Komuna XXX Pregled rezultata za 2021. godinu za opštinski grant učinka - Opština XXX		
#	Kushti minimal Minimalni uslov	Vlerësimi Procena
	Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar	
	Opštine su trebale da prijave podatke u SUOU -u prema predviđenim rokovima	
	Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës	
	Opštine su se trebale pridržavati zakonske obaveze kako bi razmotrili opštinske akte koje je nadzorni organ procenio kao nezakonite	
	Opinionit i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes	
	Miëlajmje revizije bi trebalo da bude najmanje neizmenjeno sa naglaskom na pitanje	
	Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale	
	Opštine su trebale potrošiti 75% ili više konačnog budžeta za kapitalna ulaganja	
Komuna kualifikohet/nuk kualifikohet për grant të performancës komunale		
#	Fushat dhe nënfushat e treguesve të performancës Oblasti i pod oblasti pokazatelja učinka	Vlerësimi Procena
	Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës	0
	Uloga Skupštine Opštine kao nadzorni organ	
	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	0
	Uëeëe, konsulticje i sveobuhvatnost građana	
	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	0
	Transparentnost, pristup informacijama i integritet	
Vlerësimi për qeverisjen komunale Ocena za opštinsku vlast		0
	Menaxhimi financiar	0
	Finansijsko upravljanje	
	Menaxhimi i kontratës	0
	Upravljanje ugovorom	
	Menaxhimi i burimeve njerëzore	0
	Upravljanje ljudskim resursima	
Vlerësimi për menaxhimin komunal Ocena za opštinsko upravljanje		0
	Shërbimet administrative	0
	Administrativne službe	
	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	0
	Prostorno planiranje, javni transport i životna sredina	
	Arsimi parauniversitar	0
	Preduniverzitetsko pbrzovanje	
	Kujdesi parësor shëndetësor	0
	Primarna zdravstvena zaštita	
Vlerësimi për ofrimin e shërbimeve Ocena za pružanje usluga		0
Rezultati përfundimtar Konačni rezultat		0

Vlerësimi i kushteve minimale për vitin 2021 për grantin e performancës komunale 2023- Komuna XXX
 Procena minimalnih uslova za 2021. godinu za opštinski grant učinka 2023 - Opština XXX

#	Kushti minimal Minimalni uslov	Udhëzimet për vlerësim Uputstva za procenu	Vlera sipas burimit Vrednost prema izvoru	Vlerësimi Procena	Burimi i të dhënave Izvor Informacija*	Vrojtimet (në qoftë se ka) Zapažanja (ako ih ima)
1	Të dhënat e performancës komunale të raportuara në SMPK sipas afatit të përcaktuar	PO, në qoftë se komuna ka raportuar në SMPK në afat të përcaktuar. JO, në qoftë se komuna ka raportuar në SMPK pas afatit të përcaktuar.			MPL, Raporti i SMPK-së	
	Podaci učinka opština izvestavani u SUUD prema predviđenim rokovima	DA, ako je opština opština izvestavani u SUUD prema predviđenim rokovima. NE, ako opština nije izvestila u SUUD na predviđenim rokovima			MIS, Izveštaj SUUD-a	
2	Komunat duhet t'i kenë rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikqyrëse sipas kërkesave ligjore	PO, në qoftë se komuna ka rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikqyrëse sipas kërkesave ligjore. JO, në qoftë se komuna nuk ka rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikqyrëse sipas kërkesave ligjore.			Raporti i funksionimit të komunave të Kosovës për vitin 2021 i MAPL-së	
	Opštine treba da razmotre sve opštinske akte koji se smatraju protivzakonitim od strane nadzornih organa prema zakonskim zahtevima	DA, ako je opština razmotrila sve opštinske akte koji su ocenjeni kao protivzakoniti od strane nadzornih organa prema zakonskim zahtevima. NE, ako opština nije razmotrila sve opštinske akte koji su ocenjeni kao protivzakoniti od strane nadzornih organa prema zakonskim zahtevima.			Izveštaj MALS-a o funkcionisanju kosovskih opština za 2021. godinu	
3	Opinionit vjetor i auditimit së paku i 'Pamodifikuar me theksim të çështjes'	PO, në qoftë se komuna merr: 1) opinion të pamodifikuar, ose 2) opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes JO, në qoftë se komuna merr: 3) opinion të kualifikuar 4) opinion të kualifikuar me theksim të çështjes 5) opinion të kundërt, ose 6) ZKA refuzon të japë opinion			Raportet individuale të rregullsisë të publikuara nga ZKA	
	Izveštaj o reviziji sa najmanje 'Ne-modifikovano mišljenje sa isticanjem pitanja'	DA, ako opština dobije: 1) ne-modifikovano mišljenje, ili 2) ne-modifikovano mišljenje sa isticanjem pitanja NE, ako opština dobije: 3) kvalifikovano mišljenje 4) kvalifikovano mišljenje sa isticanjem pitanja 5) nepovoljno mišljenje, ili 6) NKR odriče mišljenje			Pojedinačni izveštaji o regularnosti koje je objavila NKR	
4	Së paku 75% e buxhetit për investime kapitale është shpenzuar	PO, në qoftë se komuna ka shpenzuar së paku 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale JO, në qoftë se komuna ka shpenzuar më pak se 75% të buxhetit final për investime kapitale			Raportet individuale të rregullsisë të publikuara nga ZKA	
	Najmanje 75% budžeta za kapitalne investicije je potrošeno	DA, ako je opština potrošila najmanje 75% ili više od finalnog budžeta za kapitalne investicije NE, ako je opština potrošila manje od 75% finalnog budžeta za kapitalne investicije			Pojedinačni izveštaji o pravdnosti koje objavljuje NKR	

Komuna i ka/nuk i ka plotësuar të gjitha 4 kushtet minimale
 Opština je ispunila/nije ispunila sva 4 minimalna uslova

* Rezultati i referohet vershonit në gjuhën shqipe të burimit të të dhënave
 * Rezultat se odnosi na albanstoj verziji izvora podataka
 ** ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit
 ** NKR - Nacionalna Kancelarija Revizije
 *** MPL - Ministria e Pushtetit Lokal
 *** MIS - Ministarstvo Lokalne Samouprave

Vlerësimi i performancës për vitin 2021- Komuna XXX

#	Treguesi	Udhëzimet për vlerësim	Vlera sipas burimit	Pikët max	Vlerësimi	Burimi i të dhënave	Komentet
1	Qeverisja Demokratike			38	0		
I	Roli i Kuvendit Komunal si Organ i Rregullor			11	0		
1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50%-99.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 100%. 	0.00%	2	0	Raporti i SMPK, Numri i treguesit 3.2.1	
2	Diskutimi për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 74.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është 75% - 100%. 	0.00%	3	0	Raporti i SMPK, Numri i treguesit 3.2.2	
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin paraprak	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është më i vogël se 100%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 100%. 	0.00%	2	0	Raporti i SMPK, Numri i treguesit 3.2.3	Ky tregues nuk është vlerësuar. Për më shumë sqarime, mund t'i referoheni Rregullave të Grantit të Performancës Komunale për Vitin Fiskal 2023.
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është më i vogël se 49.99%, 2 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është 50% - 99.99%, 4 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është 100%. 	0.00%	4	0	Raporti i SMPK, Numri i treguesit 3.2.4 dhe 3.2.5	
5	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 89.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	0.00%	2	0	Raporti i SMPK, Numri i treguesit 3.2.6	
II	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve			12	0		
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike, i disagreguar sipas gjinisë	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse mesatarja e dy treguesve e rezultatit në SMPK është më i vogël se 39.99%, 1 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK për është prej 40% - 69.99%, 2 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është prej 70% - 89.99%, 4 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është e barabartë ose më e madhe se 90%. 	0.00%	4	0	Raporti i SMPK, Numri i treguesit 3.1.2 dhe 16.2.3	
